



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:053619
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05374707

Rev.nr.57/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Rrustem Thaqi dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditëses P. M. nga Gj., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gj., kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar V. Sh., për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shpenzimeve të udhëtimit dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me revizionin e paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.6144/23, të datës 05.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditëses P. M. nga Gj., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.6144/23, të datës 05.12.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.308/2022, të datës 31.05.2023, është vendosur: I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses P. M. nga Gj., përmes së cilës ka kërkuar që të “detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses të lartcekur, për periudhën kohore nga 01.01.2015 e deri më datë 18.12.2016, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit t’ia paguajë shumën prej 890.00.€, në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumën prej 934.50€, si dhe në emër

të shpërblimit jubilar për mbi 40 vite përvojë pune shumën prej 1,372.08€, në shumë të përgjithshme prej 3,196.58€, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale” II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin Ac.nr.6144/23, të datës 05.12.2023, ka vendosur që të: Refuzohet si e pathemeltë ankesa e paditëses P. M. nga Gj., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i përgjithshëm C.nr.308/2022, i datës 31.05.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizionin i autorizuari i paditëses, avokat Ilir Rugova, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të pranojë si të bazuar revizionin, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, të ndryshoj ashtu që: të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses si e bazuar.

E paditura në përgjigje në revizion ka kundërshtuar pretendimet e palës paditëse dhe ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që ta refuzoi revizionin si të pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215 gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj me datën 21.03.2022, kundër të paditurës, ka parashtruar padi, për kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të punës (shujtave), kompensimin e udhëtimit dhe shpërblimit jubilar për periudhën nga data 01.01.2015 e deri me datën 18.12.2016, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia ashtu që të detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguaj shumën prej 3,196.58€, dhe atë për shpenzime të ushqimit shumën prej 890.00€, për shpenzimet të udhëtimit shumën prej 934.50 € dhe në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 1,372.08€. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses për shkak të parashkrimit duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura, pa shqyrtim kryesor të çështjes, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes si në aktgjykimin e atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm. Aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht dhe sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se kërkesëpadija e paditëses është parashkruar duke vlerësuar prapësimin e parashkrimit të paraqitur nga e paditura me rastin e dhënies së përgjigjes në padi. Në rastin konkret, paditësja me padi ka kërkuar shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit për periudhën data 01.01.2015 e deri me datën 18.12.2016, ndërsa padinë në gjykatë e ka dorëzuar në vitin 2022, andaj në rastin konkret Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë me të drejtë i është referuar dispozitës së nenit 87 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212 me të cilën përcaktohet afati i parashkrimit për kërkesat nga marrëdhënia e punës, me të cilën dispozitë në mënyrë specifike përcaktohet se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës".

Në rastin konkret nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga vërtetimet me nr.... dhe nr...., të lëshuara nga e paditura, rezulton se paditësja ka përvojë pune tek e paditura 43 vite e 6 muaj, ku referuar këtyre vërtetimeve paditësja 40 vjetorin jubilar të punës tek e paditura e ka arritur në vitin 2013, ndërsa padinë në gjykatë e ka ushtruar me datë 21.03.2022, që rezulton se nga koha kur paditësja e ka arritur jubileun e deri në datën e paraqitjes së padisë në gjykatë kanë kaluar më shumë se 9 vite, nga çka rezulton se kërkesa e padisë edhe për këtë pjesë është parashkruar.

Gjykata e Apelit gjeti se nuk qëndron pretendimi ankimor i të autorizuarit të paditëses së gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 341, paragrafi 3 të LMD-së, duke pretenduar se e paditura nuk ka përmendur parashkrimin dhe se gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin në qoftë se debitori nuk thirret në atë, pasi që në rastin konkret e paditura me anë të përgjigjes në padinë është thirrur në parashkrim të kërkesës duke kërkuar kështu që gjykata kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pathemeltë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë dhe të gjykatës së shkallë së parë, pasi që aktgjykimet e instancave me të ulëta nuk janë të përfshira në shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Supreme e vlerësoi të pabazuar pretendimin e paditëses se kërkesa e tij nuk është parashkruar, për arsye se në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës - Ligji nr. 03/L-212, i datës 01.11.2010, përcaktohet se: Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 - vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, dhe duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, rrjedh se kërkesëpadia e paditëses është parashkruar, për faktin se padia është parashtruar me datë 21.03.2022 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e ushqimit në punë dhe shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore prej datës 01.01.2015 deri me datë 18.12.2016.

Sa i përket kërkesës për shpërblim jubilar në emër të 40 viteve të përvojës së punës, gjykata në rastin konkret konstatoi se paditësja ka filluar punën me datë 01.11.1973, ashtu që 40 vitet e përvojës së punës i ka mbushur me datë 01.11.2013, pra shumë kohë para se të hy në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe në atë kohë nuk ka qenë në fuqi as Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nr.36 e datës 18.06.2014, ndërsa padia është paraqitur jashtë afatit të paraparë me ligj.

Ndërsa për sa i përket pretendimit të revizionit se pala e paditur nuk është thirrur në parashkrim, Gjykata Supreme nga shkresat e lëndës gjeti se e paditura mund të mos e ketë precizuar bazën ligjore por në përgjigje ka theksuar se "kjo kërkesë është parashkruar dhe nuk mund të realizohet përmes kësaj padie". Duke qenë se pala e paditur ka pretenduar parashkrimin gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë e kanë zbatuar dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës - Ligji nr. 03/L-212. Prandaj ky pretendim i revizionit u refuzua si i pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.57/2024, datë 23.02.2024

Kryetar i kolegjit
Beshir Islami